

PSH.nr.118/21

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, në përbërje të Nuhi Paçarizi - Kryetar, Blerim Dina - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “Bajram Ha. Gashi B.I. (BG-ING)” – Suharekë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë OE “NN XH.KOLOLLI” Budakovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Rregullimi i infrastrukturës për Qerdhën në Studenqan-Faza e dytë”, me nr. të prokurimit “624-20-6981-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”, më datën: 25.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Bajram Ha. Gashi B.I. (BG-ING)” – Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i infrastrukturës për Qerdhën në Studenqan-Faza e dytë”, me nr. të prokurimit: “624-20-6981-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit, me titull “Rregullimi i infrastrukturës për Qerdhën në Studenqan-Faza e dytë”, me nr. të prokurimit: “624-20-6981-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik: OE “Bajram Ha. Gashi B.I. (BG-ING)” – Suharekë, aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik “Bajram Ha. Gashi B.I. (BG-ING)” – Suharekë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt. 08.02.2021 me nr. 118/21, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rregullimi i infrastrukturës për Qerdhën në Studenqan-Faza e dytë”, me nr. të prokurimit: “624-20-6981-5-2-1”, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – “KK Suharekë”, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 57, 59, 60 dhe 72 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe 39.3, 39.4, 39 dhe 41 të RRUOPP-së.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 10.02.2021, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 18.02.2021, lidhur me pretendimin ankimor të OE ankues sqaron si në vijim:

Pas shqyrtimit në detaje të lëndës së tenderit lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, eksperti shqyrtues jep këtë mendim si në vijim:

Sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që Autoriteti Kontraktues ka eliminuar këtë të fundit pa të drejtë duke mos pranuar arsyetimin e çmimeve të ofertuara si përgjigje e kërkesës për sqarime shtesë konform LPP-së, Eksperti Shqyrtues pas vlerësimit të dokumentacionit të tenderit jep këtë përgjigje:

- Me datë 11.01.2021, Autoriteti Kontraktues ka dërguar Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit drejt OE ankues duke konsideruar që tenderi i OE ankues është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës. Për të vlerësuar tenderin në mënyrën e duhur, AK ka kërkuar nga OE ankues që të japin një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit tuaj, si në vijim: 1. Shtyllat dhe Kabllot Furnizuese - në pozicionin 3, 2. Punët e Oborrit dhe Parkimit - në pozicionin 1.1

dhe 1.9 3. Punët e rrethojës - ne pozicionin 2.3 , 2.4 dhe 2.5.

- Arsyetimi mbi çmimet e ofertuara nga OE ankues dërguar më datë 12.01.2021 (shih faktin me nr.1) ka një bazë të argumentit gjithëpërfshirës dhe nuk adreson secilin pozicion ndaras. Thënë ndryshe, dekompozimi i arsyetimit për pozicionet e lartpërmendura së bashku me dokumentet mbështetëse të një arsyetimit të tillë mungon, duke mos qartësuar në përpikëri kërkesën për sqarime shtesë të Autoritetit Kontraktues.
- Konform nenit 61 të LPP-së për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, gjegjësisht paragrafit të katërt, Pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin.
- Konform Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, kronologjinë e rastit në fjalë dhe natyrën e pretendimeve, Eksperti shqyrtues e sheh ankesën e operatorit ekonomik ankues si të pabazuar, duke sugjeruar kështu që vendimi i Autoritetit Kontraktues për aktivitetin e prokurimit numër “624-20-6981-5-2-1”, respektivisht atij me titull “Rregullimi i infrastrukturës për Qerdhën në Studenqan-Faza e dytë”, iniciuar nga AK – KK-Suharekë, të mbetet në fuqi.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues duhet të jetë: e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AK-së.-

Autoriteti kontraktues me datë 19.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik me datë 21.02.2021, me anë të parashtresës ka njoftuar OSHP-në se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Me datën 08.02.2021 pranuar raportin e ekspertizës të ekspertit shqyrtues me të cilin nuk pajtohem, faktin që i njëjti nuk është marrë fare me shqyrtimin e pretendimeve tona ankore të parashtruara në ankesë. Eksperti

shqyrtues në raportin e tij vetëm citon nenin 61 të LPP, dhe në asnjë rast të këtij raporti nuk i citon apo përmend faktet dhe pretendimet tona në ankesë.

Kërkojmë nga paneli shqyrtues që ta hudhë poshtë raportin e ekspertit, dhe të organizojë seancë dëgjimore me qëllim të trajtimit të pretendimeve tona dhe dhënien e argumenteve tona, se oferta jonë është në përputhje me LPP dhe kërkesave të DT...

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën 23-02-2021, të mbajtur në platformën elektronike ZOOM në ora 11:00, ku morën pjesë të gjithë anëtarët e panelit shqyrtues, përfaqësuesi i OE-së ankues nuk ka qenë prezent në seancë, përfaqësuesit AK-së, eksperti shqyrtues.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me përbërjen e panelit, dhe pasi konstatoi se nga të pranishmit nuk pati vërejtje në këtë përbërje, vazhdoi me seancën.

Kryetari i panelit i njoftoi të pranishmit me objektin e shqyrtimit si dhe me shkresat e lëndës dhe në vazhdim fjalën ia dha. Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK i cili deklaroi: AK pajtohet me mendimin e ekspertit në qeshtje me lidhje me ankesën e OE me rastin e procedurës së aktivitetit të prokurimit "Rregullimi I infrastrukturës për çerdhen e fëmijëve në Studenqan-faza e dytë" AK pas vlerësimit të ofertave me na të komisionit ka kërkuar disa sqarime të OE ankues lidhur me disa pozicione që janë çmime jo konkurrues të uletë sidomos mbjatsja të qeshtja e hekurti ku na ka sjellë 0.4 cent kilogramin e hekurit se na e dimë që në treg sillet dikund 60 cent edhe në përshkrimin e edhe arsyetimin me secilin na e ka ofruar operatori ka bërë vetëm një përshkrim të punëve pa asnjë lloj dëshmie se si ka marrë këtë furnizim qoftë të kabllovet furnizues qoftë të furnizimi me beton me të cilin ka dhënë 40 euro për meter kub dhe na e dimë që tregu është krejt ndryshe po ashtu edhe tek armatura andaj sqarimi që na ka sjellë OE nuk është aspak bindës veç ka bërë një përshkrim që unë kom kapacitet të mjaftueshëm për mi krye këto punë se kom marrëveshje me furnitor e sënë mirpo kapaciteti në punëtor nënkupton që ti në treg e sjellësh çmimin me 4 cent kg e hekurit, andaj edhe mbas këtij përshkrimi që e ka sjellë OE atëherë na e kemi pa që nuk është serioze edhe nuk na ka sjellë detaje se si mund të kryej këto pozicionet bëhet fjalë për disa pozicione shtylla të kabllovet furnizues pozicioni 3 puna pranë oborrit të parkimit 1.1 dhe 1.9 edhe punët e rrethojës pozicioni 2.3 2.4 2.5 edhe të furnizimi me dhe dhe mbjellja e barit e ka dhënë për zero pik 5 cent furnizim me dhe ngjeshja rrafshimi dhe mbjellja e barit për qaka nuk kemi një lloj dëshmie se si ka marrë këto punë edhe kjo është arsyeja pse OE është eliminuar nga kjo ofertë.

Propozoj që ta aprovo vendimin e AK dhe të refuzoj ankesën e OE ankues si të pa bazuar.

Ne fjalën përfundimtare Eksperti deklaroj : unë siç edhe shpjegohet ne raportin e ekspertizës unë e kom te njëjtën pik te logjikes edhe te argumentimit si te AK konform LPP dhe nenit 61 për tender jo normalisht te ulët pas marrjes parasysh te informacioneve dhe te sqarimeve te dorzume nga tenderuesit sipas paragrafit te par AK ka vendosur qe tenderi është jo normalisht i ulët për faktin se sa i perket sqarimeve te dorëzuara nga OE ankues nuk kanë qen le te themi te dekompozuar mir dhe nuk kanë qen te dokumentuara me materiale mbështetse , OE i ka dhen disa argumente te përgjithshme per nga ana e përgjigjes ndaj kërkesës për sqarim te cilat sipas mendimit tim nuk perkojn me detaje nuk perkojn me adresimin e pyetjeve te AK-së nuk perkojn me pozicione kështu qe qëndroj prapa ekspertizës .

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të ankesës së OE ankues, sqaron se pretendimet ankimore kanë të bëjnë me arsyet e eliminimit të OE ankues nga ana e autoritetit kontraktues. Pas shqyrtimit në detaje të lëndës lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe duke u bazuar në dokumentacionin në dispozicion, sa i përket pretendimit ankimor të OE ankues ku thuhet që Autoriteti Kontraktues ka eliminuar këtë të fundit pa të drejtë duke mos pranuar arsyetimin e çmimeve të ofertuara si përgjigje e kërkesës për sqarime shtesë konform LPP-së, Paneli Shqyrtues sqaron se me datë 11.01.2021, autoriteti kontraktues ka dërguar Letrën Standarde të kërkesës për sqarimin e tenderit drejt OE ankues, duke konsideruar që tenderi i OE ankues është jo-normalisht i ulët në krahasim me objektin e kontratës. Për të vlerësuar tenderin në mënyrën e duhur, AK ka kërkuar nga OE ankues që të japin një shpjegim detal të elementeve përbërëse të tenderit, si në vijim: 1. Shtyllat dhe Kabllot Furnizuese - në pozicionin 3, 2. Punët e Oborrit dhe Parkimit - në pozicionin 1.1 dhe 1.9; 3. Punët e rrethojës - ne pozicionin 2.3 , 2.4 dhe 2.5.

Lidhur me këtë kërkesë të AK-së, Paneli Shqyrtues sqaron se OE ankues me datë 12.01.2021 ka dhënë arsyetimin mbi çmimet e ofertuara, edhe pse për AK arsyetimi për pozicionet e lartpërmendura së bashku me dokumentet mbështetëse të një arsyetimit të tillë mungon. Megjithatë, Paneli Shqyrtues konsideron se edhe pse OE ka dhënë përgjigjet e veta në mënyrën si e vlerëson në aspektin ekonomik, Paneli Shqyrtues konsideron se nuk e ka bindur AK me sqarimet e dhëna. Andaj, ky pretendim i OE ankues është pjesërisht i bazuar për shkak të sqarimeve të dhëna, megjithatë nuk ndikon në rezultatin përfundimtar. Kjo për arsye se sipas nenit 61 të LPP-së për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, gjegjësisht paragrafit të katërt, pas marrjes parasysh të informacioneve dhe sqarimeve të dorëzuara nga tenderuesi sipas paragrafit 1. të këtij neni, nëse autoriteti kontraktues vendos se tenderi është jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të refuzojë tenderin. Gjithashtu, konform Rregullave për Tenderët Jo-Normalisht të Ulët, Gjatë përcaktimit se nëse një tender është jo normalisht i ulët, Autoriteti kontraktues duhet të merr në konsideratë ekonominë e procesit të prodhimitarisë, të shërbimeve të ofruara dhe/ose të metodave të ndërtimit; çfarëdo zgjidhje teknike që janë ofruar ose zgjedhur; çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve, sigurimin e shërbimeve, ekzekutimin e projekteve të punëve dhe/ose ushtrimin e

aktiviteteve të ndërtimit që janë duke u prokuruar; dhe/ose origjinalitetin e furnizimeve, shërbimeve, punës ose punëve të propozuara.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka zbatuar në mënyrë të drejtë “Rregullat për Tenderët Jo-Normalisht të ulët”, pasi që sqarimet e dhëna nga OE ankues nuk kanë qenë bindëse në lidhje me ekonomin e prodhimit apo në rastin konkret nuk ka dhënë çfarëdo kushte veçanërisht të favorshme që janë në dispozicion për tenderuesin për furnizimin e produkteve. Andaj, gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, Paneli Shqyrtues konsideron se autoriteti kontraktues ka pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit dhe ka vepruar në harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK “KK-Suharekë”;
- 1x1 OE Bajram Ha. Gashi B.I. (BG-ING);
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.